

SUBORDINATE TIME CLAUSES - AN ISSUE TO BE SOLVED PERIUDHAT ME SIFJALI TË NËNRENDITURA KOHORE – NJË PROBLEM QË DUHET ZGJIDHUR

Nertila RAMADANI¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: nertila.sinani@unite.edu.mk

Përmbledhje

Studimet gjuhësore, viteve të fundit po orientohen drejt gjuhësisë së zbatuar dhe problemeve që dalin nga ajo, të cilat kryesisht mbështeten në praktikën e përditshme ligjërimore. Edhe studimet sintaksore, si shkencë, që merret me studimin e mënyrës si kombinohen fjalët për të krijuar fraza dhe fjali në një gjuhë të caktuar, duhet të orientohen në këtë drejtim. Nëpërmjet këtij hulumtimi synojmë të zbulojmë vështirësitë e studentëve në lidhje me njohjen, përdorimin, kuptimin e lidhëzave kohore, drejtpërdorimin e tyre në fjali si dhe dallimin e periudhave me sifjali të nënrenditura kohore me periudhat me sifjali tjera nënrenditëse, të formuara me lidhëza kohore.

Të dhënat për realizimin e këtij studimi janë mbledhur nga anketa e realizuar online me studentët e katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe që vijojnë studimet në Universitetin e Tetovës. Metodën që janë përdorur gjatë hartimit të punimit janë metoda e anketimit dhe ajo përshkruese si forma më të përdorura gjatë hulumtimeve aktuale me qëllim që të përftohet material më i begatë dhe të përshkruhen më rrënjësisht dukuritë gjuhësore që hulumtohen me të gjitha karakteristikat e tyre.

Fjalët kyçe: lidhëzat, periudhat e nënrenditura me sifjali kohore, studentët, krahasimi.

Hyrje

Ky studim ka për qëllim të sigurojë një pasqyrë empirike dhe statistikore rreth përdorimit të periudhave me sifjali të nënrenditura kohore nga ana e studentëve. Qëllimet e hulumtimit do të realizohen përmes përgjigjeve në pyetjet: A i njohin studentët periudhat me sifjali të nënrenditura kohore? Sa shpesh i përdorin këto periudha? Cilat lidhëza më tepër i përdorin ata? A mund të bëhen përgjithësime e grupime rreth përdorimit të periudhave me sifjali kohore, të ndërtuara me lidhëza të ndryshme?

Në lidhje me pyetjet e lartshënuara, qëllimet e punimit lidhen me:

- Hulumtimin e gabimeve më të shpeshta që bëjnë studentët gjatë përcaktimit të llojit të periudhave;

- Caktimin e arsyes përse studentët i bëjnë këto gabime;

- Gjetja e mënyrave se si të tejkalohen këto probleme.

Hipotezat kryesore dalin nga pyetjet kyçe të problemit tonë hulumtues:

- Gabimet më të shpeshta në përcaktimin e llojeve të periudhave hasen te studentët e vitit të parë dhe të dytë;

- Përgjithësisht studentët hasin vështirësi në përcaktimin e periudhave të ndërtuara me lidhëzat ndërsa, teksa, gjersa, derisa, si dhe me periudhat jolidhëzore.

- Lidhëza që përdoret më shpesh nga studentët është lidhëza kohore *kur*.

Për testimin e hipotezave të lartpërmendura i përdorëm metodat kualitative, përshkruese, për shpjegimin teorik të problemit që e hulumtojmë dhe metodën kuantitative të anketimit të drejtpërdrejtë për të mbledhur të dhëna konkrete.

Pyetjet e anketës ishin të strukturuar në tre nivele. Niveli fillestar kërkonte njohuri të përgjithshme për fjalitë e përbëra nënrenditëse me sifjali kohore, duke u kërkuar studentëve të plotësojnë foljet që mungojnë apo të shënojnë vetë disa periudha të tilla. Pjesa e dytë e pyetjeve lidhej me përdorimin e shpeshtë të lidhëzave. Detyra e studentëve në këtë pjesë ishte të përcaktonin njërën nga lidhëzat kohore të listuara në pyetësor, të cilën e përdornin më shpesh apo e cila i përshtatej më së miri fjalisë.

Pjesa e tretë e pyetjeve lidhej drejtpërdrejt me njërën nga çështjet kyçe të studimit tonë, njohjen e periudhave me fjali të nënrenditur kohore, njëjtësimin e tyre me lidhëzat kohore, ndryshorët që ndikojnë në njohjen apo mosnjohjen e këtyre periudhave etj. Në këtë studim analiza është kryesisht përshkruese dhe e grupuar në bazë të ndryshorit: *viti i studimeve*.

Rezultatet dhe diskutimi

Sintaksa e gjuhës shqipe, duke përfshirë njësitë sintaksore, sintagmat, fjalitë e periudhat, mësohet që në shkollë fillore për të vijuar më hollësisht në atë të mesme e në studimet tjera të mëtejme, që do të thotë se kur studentët regjistrohen në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe kanë paranojë për këto të dhëna. Meqenëse nuk janë objekt i studimit tonë nuk i kemi marrë t'i analizojmë programet dhe tekstet e shkollave fillore dhe të mesme, por nga njohuritë paraprake konsiderojmë se të dhënat në lëmin e sintaksës janë të mjaftueshme, ndërkaq sa dhe si punohet kjo fushë në ciklet paraprake mbetet për t'u hulumtuar në terren.

Të njohësh gabimet është vërtet e rëndësishme, ndërkaq të studiosh dhe të zbulosh burimin e gabimeve është një hap drejt hulumtimit të progresit të studentëve në mësimin e gjuhës dhe drejtpërdorimin e saj. Në këtë hulumtim jemi munduar të zbulojmë gabimet më të shpeshta të studentëve në lidhje me ndërtimin e periudhave të ndryshme me anë të lidhëzave kohore. Në periudhat me fjali të varur rrethanore një dukuri problematike janë përdorimi i lidhëzave homonimike. Këto sjellin herë-herë vështirësi në përcaktimin e llojit funksional dhe të nënlojit semantik të fjalive të varura. Vërehen kalime prej një kategorie në tjetrën, gërshetime raportesh e ngjyrimesh (ASHSH, 2002/b, f.498).

Në vijim po i pasqyrojmë rezultatet e anketës, për të marrë të dhëna më të sakta rreth njohjes së periudhave me sifjali të nënrenditura kohore, pyetjeve kërkimore, dëshmimit të hipotezave: Anketës iu përgjigjën 27 studentë nga viti i parë deri në të katërtin. Më konkretisht nga 5 studentë janë përgjigjur nga viti i parë dhe i dytë, 7 nga viti i tretë dhe 10 studentë të vitit të katërt (tabela në vijim).

Tabela nr.1: Viti i studimeve			
		Nr.	%
	Viti i parë	5	3.9
	Viti i dytë	5	3.9
	Viti i tretë	7	5.5
	Viti i katërt	10	7.9
	Gjithsej	27	21.3

Në pyetjen e parë, në të cilën kërkohej nga studentët të vendosin foljen në kohën e duhur, gati të gjithë kanë dhënë përgjigje të saktë. Ndryshimi qëndron në përzgjedhjen e vetave. Po ilustruam disa përgjigje të studentëve: *Pasi lëviz disa herë mbi minder pyeti për djemtë. Pasi lëviz disa herë mbi minder pyeta për djemtë. Ndërsa po kthehesim, në rrugë u ndeshëm me inxhinierin. Ndërsa po ktheheshin, në rrugë u ndeshën me inxhinierin.*

Në pyetjen e dytë studentët kishin për detyrë të shkruajnë disa fjali të përbëra me sifjali të varur kohore. Shumica e përgjigjeve janë të sakta, sepse studentët kanë pasur mundësi të konsultojnë literaturë (këtë e vërtetojmë përmes disa shembujve të njëjtë të shkruar nga studentë të ndryshëm), por ekziston edhe një numër i vogël i përgjigjeve të gabuara:

Tabela nr. 2: Shembuj të marrë drejtpërdrejt nga përgjigjet e studentëve	
Përgjigje të sakta	Përgjigje të gabuara
1 . Kur po kthehesha nga puna, takova nje shoqe fëmijërie. 2 . Kur ra mbrëmja, u dëgjuan dallgë të shpeshta. 3 . Sapo doli mjeku nga spitali,erdhi një urgjencë. 4 . Kur doli në lëndinë, djaloshi pa liqenin e madh. 5 . Mendohu mirë, para se të flasësh. 1.Sapo doli nëna nga puna, erdhën fëmijët. 2. Gjersa shkoja në shkollë, u takova me mësuesin tim të parë. 3. Sytë i qeshnin kur ajo fliste. 4. Sa të rrosh do të mësosh. 5. Kur perëndoi dielli, ne qëndronim buzë detit.	1. Mirë po unë isha aty, a tjerët nuk erdhën. 2. Mësuesja spjegonte, ndërsa nxënësit nuk e kuptuan. 3. Ajo duket e fort, por nuk ka fuqi. 4. Vetëm ajo këndonte, tjerët dëgjonin. 5. Po ajo më thirri dhe nuk erdhi. 1. Prej larg e vërejtja se ajo nuk ishte mirë. 2. Nxënësi, që studimin e ka primar, korr sukses. 3. Kjo është vajza për të cilën të tregoja dje. 4. Fillova ta shkruaj hartimin, por më ndërpreu nëna. 5. Dihet se Hëna është i vetmi satelit natyror i Tokës.

Pjesa e dytë e pyetjeve lidhej me dendurinë e përdorimit të lidhëzave. U munduam të zbulojmë cilën nga lidhëzat e përdorin më tepër. Këto pyetje u formuluan në mënyrë që lidhëzat ishin të radhitura në përshkallëzim vertikal, ndërsa studentët e përzgjidhnin lidhëzën përmes klikimit në njërin prej tyre. Për të parë a ndikon radhitja në përzgjedhje, nga një pyetje në tjetrën ua kemi ndërruar vendin lidhëzave. Në vijim do të paraqesim rezultatet e këtyre pyetjeve:

Tabela nr. 3: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: Hekuri rihet _____ është i nxehtë			
		Nr	%
Lidhëzat	Derisa	2	1.6
	Sa	22	17.3
	Kur	3	2.4
	Total	27	21.3

Tabela nr. 4: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____ e mori veten nga sëmundja, vazhdoi t'i ndjekë rregullisht mësimet.			
		Nr	%
Lidhëzat	sa	4	3.1
	kur	4	3.1
	sapo	16	12.6
	ndërsa	1	.8
	gjersa	2	1.6
	Total	27	21.3

Nga tabelat e mësipërme vërejmë se lidhëzat më shpesh të përdorura janë *sa* (22 herë) dhe *sapo* (16 herë). Në pyetjen “**Hekuri rihet _____ është i nxehtë**” asnjë student nuk ka përzgjedhur përgjigjet *teksa*, *gjersa* dhe *derisa*, ndërkaq në shembullin “**_____ e mori veten nga sëmundja, vazhdoi t’i ndjekë rregullisht mësimet**” aspak nuk janë përzgjedhur lidhëzat: *porsa*, *teksa*, *derisa*.

Tabela nr. 5: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____vjen pranvera, çelin lulet			
		Nr	%
Lidhëzat	Sa	1	.8
	Kur	20	15.7
	Sapo	3	2.4
	Porsa	3	2.4
	Total	27	21.3

Tabela nr. 6: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____ të mbërrish të lutem na njofto			
		Nr	%
Lidhëzat	Sa	9	7.1
	Kur	6	4.7
	Sapo	8	6.3
	Porsa	3	2.4
	Total	26	20.5

Në shembullin e parë (_____vjen pranvera, çelin lulet.) vërejmë se më dendur përdoret lidhëza *kur* (20 herë), ndërkaq në të dytin (_____ të mbërrish të lutem na njofto) ka një barasvlershmëri mes përdorimit të lidhëzave *sa* dhe *sapo*. Lidhëza *si* nuk është përzgjedhur aspak, ndërkaq do të ishte shumë i saktë dhe i qëlluar edhe formulimi *Si të arrish të lutem na njofto*.

Tabela nr. 7: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____mbaroi bukën, ndezi një cigare dhe shkoi të flinte			
		Nr.	%
Lidhëza	Sa	7	5.5
	Kur	2	1.6
	Sapo	10	7.9
	Porsa	2	1.6
	Si	6	4.7
	Total	27	21.3

Tabela nr. 8: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: U arrestuan vetëm dje, _____përpiqeshin të kalonin nga Shqipëria në Mal të Zi			
		Nr	%
Lidhëza	Kur	3	2.4
	Sapo	1	.8
	Gjersa	6	4.7
	Teksa	17	13.4
	Total	27	21.3

Përzgjedhja më e shpeshtë nga shembujt e mësipërm kanë qenë periudhat: *Sapo mbaroi bukën, ndezi një cigare dhe shkoi të flinte.*; *U arrestua vetëm dje, teksa përpiqeshin të kalonin nga Shqipëria në Mal të Zi.*

Tabela nr. 9: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____ ishte nisur për këtu kishte po atë mendim			
		Nr.	%
Lidhëzat	derisa	10	7.9
	kur	8	6.3
	sapo	1	.8
	gjersa	5	3.9
	porsa	1	.8
	teksa	2	1.6
	Total	27	21.3

Tabela nr. 10: Në vend të vijës shënoni lidhëzën që mendoni se i përshtatet më së miri periudhës: _____ bisedonin, u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe krisma mitralozi			
		Nr .	%
Lidhëzat	derisa	8	6.3
	kur	3	2.4
	sapo	1	.8
	ndërsa	2	1.6
	gjersa	4	3.1
	teksa	9	7.1
	total	27	21.3

Në shembujt e fundit lidhëzat e përdorura më shpesh janë: *derisa, kur* dhe *teksa*. Parë në përgjithësi, lidhëzat më shpesh të përdorura janë: *sapo, sa, teksa, derisa, kur*, ndërsa lidhëzat që nuk janë zgjedhur shpesh janë: *si, gjersa, ndërsa, porsa*. Kësisoj hipoteza se studentët e përdorin më së tepërmi lidhëzën kohore *kur* vërtetohet vetëm pjesërisht. Lidhëzat homonimike realisht paraqitën probleme në dallimin e fjalive të përbëra me sifjali të nënrenditur kohore.

Duke u bazuar vetëm në strukturën e periudhave të dhëna e duke mos i zëvendësuar lidhëzat me të tjera përkatëse, në shumicën e rasteve studentët nuk i kanë qëlluar përgjigjet. Alternativat për përzgjedhje kanë qenë të njëjta për të gjitha periudhat: *kohore, shkakore, kushtore, përqasore-kundershtore, lejore*. Në këtë grup rezultatet i kemi grupuar sipas ndryshorit: *viti i studimeve* për të parë a ndikon mësimi i lëndës së Sintaksës në vitin e tretë në përvetësimin e këtyre dallimeve.

Po i pasqyrojmë fillimisht përgjigjet e fjalive të përbëra me sifjali të nënrenditur kohore.

Teksa udhëtonte në mes të natës me automjetin e tij, ka humbur kontrollin, duke gjetur vdekjen.			
Viti	Periudha	Nr	%
1	Kohore	3	75.0
	Përqasore-kundershtore	1	25.0
2	Kohore	3	60.0
	Shkakore	2	40.0
3	Kohore	6	85.7
	Shkakore	1	14.3
4	Kohore	4	44.4
	Shkakore	4	44.4
	Përqasore-kundershtore	1	11.1

Duke ardhur rrugës, e takova mësuesin tim të parë.			
Viti	Periudha	Nr.	%
1	Kohore	3	75.0
	Shkakore	1	25.0
2	Kohore	4	80.0
	Kushtore	1	20.0
3	Kohore	7	100.0
4	Kohore	8	88.9
	Përqasore-kundershtore	1	11.1

Ndërsa fshatarët lidhnin duajt, nxënësit mblidhnin kallinjtë.			
Viti	Periudha	Nr	%
1	Kohore	2	50.0
	Perqasore-kundershtore	2	50.0
2	Kohore	2	50.0
	Perqasore-kundershtore	2	50.0
3	Kohore	4	57.1
	Kushtore	1	14.3
	Perqasore-kundershtore	2	28.6
4	Lejore	1	12.5
	Kushtore	4	50.0
	Perqasore-kundershtore	3	37.5

Ndërsa ai përpëlitej në njërin nga qoshet e qelisë unë zura vend këmbëkryq mbi postajë.			
viti	Periudha	Nr.	%
1	Kohore	1	25.0
	Lejore	1	25.0
	Perqasore-kundershtore	2	50.0
2	Kohore	1	25.0
	Kushtore	1	25.0
	Perqasore-kundershtore	2	50.0
3	Kohore	2	28.6
	Shkakore	2	28.6
	Perqasore-kundershtore	3	42.9
4	Kohore	1	11.1
	Lejore	3	33.3
	Kushtore	1	11.1
	Perqasore-kundershtore	4	44.4

Tek shkante rrugës, sytë i vajtën në një kopsht me pemë e me lule.			
Viti	Periudha	Nr.	%
1	Kohore	3	75.0
	Shkakore	1	25.0
2	Kohore	1	25.0
	Shkakore	1	25.0
	Lejore	1	25.0
	Perqasore-kundershtore	1	25.0
3	Kohore	7	100.0
4	Kohore	3	33.3
	Shkakore	2	22.2
	Lejore	1	11.1
	Kushtore	3	33.3

Tani që mbeti vetëm, ai e kuptoi sa shumë ishte lodhur.			
Viti		Nr.	%
1	Kohore	3	75.0
	Perqasore-kundershtore	1	25.0
2	Kohore	2	40.0
	Shkakore	3	60.0
3	Kohore	6	85.7
	Kushtore	1	14.3
4	Kohore	2	25.0
	Shkakore	2	25.0
	Lejore	1	12.5
	Kushtore	2	25.0
	Perqasore-kundershtore	1	12.5

Teksa (ndërsa, derisa, gjersa) udhëtonte në mes të natës me automjetin e tij, ka humbur kontrollin, duke gjetur vdekjen- llojin e kësaj periudhe saktë e kanë qëlluar 75% e studentëve të vitit të parë, 60% - viti i dytë, 85.7% - viti i tretë dhe 44.4% të vitit të katërt. Periudha e formuar me formën e pashtjelluar (përcjellore): *Duke ardhur (kur po vija) rrugës, e takova mësuesin tim të parë*, është lloji që është dalluar më lehtë. Kështu, saktë janë përgjigjur 75% - viti I, 80%- viti II, 100%-viti III, 88.9%-viti IV.

Shqetësues është fakti i përgjigjeve të dhëna në dy periudhat e ndërtuara me lidhëzën *ndërsa*, e cila mund të shfaqet me funksione të ndryshme. Funksioni sintaksor i lidhëzës *ndërsa* në gjuhën shqipe është i dyfishtë, madje nëse i trajtojmë si të veçanta fjalitë me bashkërenditje përqasore dhe ato kundërshtore, së bashku me fjalitë kohore, del se funksioni sintaksor i saj është i trefishtë (B. Sulejmani, 2015, f.25). Që do të thotë se studentët e kanë marrë të “mirëqenë” vetëm formën e shkruar të lidhëzës *ndërsa* dhe aspak nuk janë orvatur të studiojnë natyrën e periudhës apo ta zëvendësojnë lidhëzën me ndonjë lidhëz tjetër kohore (teksta, gjersa, derisa, tek).

Ndërsa ai përpëlitej në njërin nga qoshet e qelisë unë zura vend këmbëkryq mbi postajë. (përgjigje të sakta: 50% - viti I dhe II, 57% - viti III dhe 0%- viti IV)

Ndërsa fshatarët lidhnin duajt, nxënësit mblidhnin kallinjtë. (përgjigje të sakta: 25% - viti I dhe II, 28.6%- viti III, 11.1%- viti IV).

Tek (teksta, ndërsa, derisa, gjersa) shkonte rrugës, sytë i vajtën në një kopsht me pemë e me lule. (përgjigje të sakta: 75%-viti I, 25% -viti II, 100%- viti III, 33%- viti IV).

Tani që mbeti vetëm, ai e kuptoi sa shumë ishte lodhur. (përgjigje të sakta: 75%-viti I 40%- viti II, 85%- viti III, 25%-viti IV).

Nga shembujt e mësipërm mund të përfundojmë se hipoteza e dytë vërtetohet plotësisht, ndërsa hipoteza e parë vërtetohet pjesërisht. Përveç studentëve të vitit të parë dhe të dytë gabime vërejmë edhe te studentët e vitit të katërt. Mund të themi se studentët jo vetëm që nuk kanë shumë parnjohuri për periudhat e nënrenditura në përgjithësi, por edhe nuk ju kushtojnë rëndësi. Në vitin e tretë, në periudhën kur mësohet lënda e sintaksës, janë më të përqendruar dhe janë përgjigjur saktë. Por, njohuritë e marra, nuk u zgjasin shumë, sepse përgjigjet e studentëve të vitit të katërt herë – herë janë edhe më të dobëta se të viteve të para e të dyta. Rrjedhimisht mund të konstatojmë se njohuritë që i fitojnë janë mekanike dhe afatshkurta.

Kur s' di not, mos u fut në det.				
Viti	Periudha		Nr.	%
1	Lidhëzat	Kohore	1	25.0
		Shkakore	1	25.0
		Kushtore	2	50.0
2	Lidhëzat	Kushtore	3	60.0
		Perqasore-kundershtore	2	40.0
3	Lidhëzat	Kohore	2	28.6
		Shkakore	1	14.3
		Kushtore	4	57.1
4	Lidhëzat	Kohore	2	25.0
		Shkakore	2	25.0
		Kushtore	2	25.0
		Perqasore-kundershtore	2	25.0

S'mund të kalojë kur s'ka mësuar.				
Viti	Periudha		Nr.	%
1	Lidhëzat	Kushtore	4	100.0
2		Lejore	1	20.0
2	Lidhëzat	Kushtore	2	40.0
		Perqasore-kundershtore	2	40.0
3	Lidhëzat	Kohore	2	28.6
		Shkakore	1	14.3
		Lejore	1	14.3
		Kushtore	2	28.6
		Perqasore-kundershtore	1	14.3
4	Lidhëzat	Kohore	1	12.5
		Shkakore	3	37.5
		Lejore	1	12.5
		Kushtore	2	25.0
		Perqasore-kundershtore	1	12.5

Përderisa ti ke vendosur të ikësh, unë nuk do të pengoj				
Viti			Nr.	%
1	Lidhëzat	Kohore	1	20.0
		Shkakore	1	20.0
		Lejore	3	60.0
2	Lidhëzat	Shkakore	2	40.0
		Lejore	1	20.0
		Kushtore	1	20.0
		Perqasore-kundershtore	1	20.0
3	Lidhëzat	Kohore	2	28.6
		Shkakore	2	28.6
		Lejore	1	14.3
		Kushtore	1	14.3
		Perqasore-kundershtore	1	14.3
4	Lidhëzat	Shkakore	3	33.3
		Lejore	2	22.2
		Kushtore	2	22.2
		perqasore-kundershtore	2	22.2

Kurdo që ta pyesësh, përgjigjet i ka gati				
Viti	Periudha		Nr	%
1	Lidhëzat	Kohore	5	100.0
2	Lidhëzat	Kohore	4	80.0
		Kushtore	1	20.0
3	Lidhëzat	Kohore	7	100.0
4	Lidhëzat	Kohore	8	88.9
		Lejore	1	11.1

Për periudhat me fjali të nënrenditur shkakore: *S'mund të kalojë kur s'ka mësuar.; dhe Përderisa ti ke vendosur të ikësh, unë nuk do të pengoj.*; studentët janë përgjigjur kështu: Për periudhën e parë: (të gjithë studentët e vitit të parë kanë zgjedhur opsionin: *kushtore*, studentët e vitit të dytë: 40% kanë zgjedhur opsionin *kushtore* dhe *përqasore-kundershtore*, ndërsa vetëm një është përgjigjur *lejore*, viti i tretë: nga 14.3 % janë përgjigjur: *shkakore*, *lejore*, *përqasore-kundershtore*, ndërsa nga 28.6% kanë përzgjedhur opsionet: *kushtore* dhe *kohore*, viti IV: nga 12.5% kanë zgjedhur opsionin: *përqasore-kundershtore*, *kohore* dhe *lejore*, 25%: *kushtore* dhe 37.5% kanë zgjedhur opsionin e saktë: *shkakore*).

Parë në përgjithësi: nga 27 studentë, vetëm 4 i janë përgjigjur saktë: 1 nga viti i tretë dhe 3 të vitit IV. Në fjalinë e dytë *Përderisa ti ke vendosur të ikësh, unë nuk do të pengoj* saktë janë përgjigjur: 1 student i vitit të parë, nga 2 të vitit të dytë dhe të tretë dhe 3 studentë të vitit të katërt. Periudhës kushtore: *Kur s'di not, mos u fut në det*, saktë i janë përgjigjur: 2 studentë të vitit të parë, 3 të vitit të dytë, 4 të vitit të tretë dhe 2 të vitit të parë.

Ndërkaq, duke e ngatërruar ndajfoljen lidhore *kurdo* me lidhëzën kohore *kur*, në periudhën me pjesë të nënrenditur lejore: *Kurdo që ta pyesësh, përgjigjet i ka gati*, asnjë student nuk i është përgjigjur saktë, përkundrazi shumica kanë zgjedhur opsionin *kohore*. Parë në përgjithësi edhe në këtë grup pyetjesh ka shumë pak përgjigje të sakta. Shkakun e problemeve të tilla e lidhim me programet dhe qasjen që i bëhet shpjegimit të sintaksës në ciklin e mesëm dhe atë të lartë. Mendojmë se duhen shmangur metodat tradicionale të ligjërimit sintaksor dhe të fokusohet më tepër në metodat inovative.

Përfundime dhe rekomandime

Nga të dhënat e grumbulluara dhe rezultatet e analizuara mund të përfundojmë se në përgjithësi studentët nuk i njohin periudhat e nënrenditura. Gabimet më të shpeshta studentët i bëjnë në periudhat e nënrenditura kohore të formuara me lidhëzat: *ndërsa*, *teksa*, *si*, apo periudhat e nënrenditura lejore, kushtore shkakore të formuara me lidhëzat kohore: *kur*. Në përdorim vërehet laramani e lidhëzave kohore: *kur*, *tek*, *sapo*, *porsa*, *teksa*, *etj*.

Sugjerimet tona lidhen me ndryshimin e qasjes në mënyrën e studimit të sintaksës dhe realizimi i ushtrimeve në këtë lëmë të orientohet kryesisht në përdorimet praktike. Në të ardhmen të bëhen hulumtime tjera me llojet tjera të periudhave dhe me dukuritë e ndryshme gjuhësore për të parë nga afër problemet që shfaqen më shpesh, arsyet përse bëhen këto gabime si dhe të sillen përfundime rreth mënyrës si mund të përmirësohen këto gabime.

Referencat

- [1]. Aidinlou, N. A., & Reshadi, E. (2014). A Comparative Study of the Use of Conjunctions and References in Electronic Mails vs. Paper-based Letters. *Journal of Language Teaching and Research*, 5(3). <https://doi.org/10.4304/jltr.5.3.611-615>
- [2]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002a). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. ASHSH.
- [3]. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (2002b). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. ASHSH.
- [4]. Carnie, A. (2011). *Modern Syntax: A Coursebook* (Illustrated ed.). Cambridge University Press.
- [5]. Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*. ILAR.
- [6]. Çeliku, M. (2016). *Tekst ushtrimesh të sintaksës së shqipes standarde*. ILAR.
- [7]. Dirga Sari, I., Syarif, H., & Amri, Z. (2018). An analysis of compound sentences in students' writing. *Advances in Social Science, Education and Humanities Research*, 301, 341–348. <https://doi.org/10.2991/icla-18.2019.57>
- [8]. Geraldine, V. (2018). ERROR ANALYSIS ON THE USE OF CONJUNCTION IN STUDENTS' WRITING RECOUNT TEXT AT VOCATIONAL STATE SCHOOL 41 JAKARTA. *Journal of Language and Literature*, 6(2), 97–104. <https://doi.org/10.35760/jll.2018.v6i2.2488>
- [9]. Grillo (Mukli), H. (2015). Hulumtime mbi njohjen, kuptueshmërinë e përdorimin e fjalive kushtore. *Filologjia*, 3(4), 120–131.
- [10]. Katičić, R. (1986). *Sintaksa hrvatskog književnog jezika*. Globus.
- [11]. Mauri, C. (2017). Conjunctions. *Oxford Bibliographies Online Datasets*. Published. <https://doi.org/10.1093/obo/9780199772810-0207>
- [12]. Nesimi, R., & Toska, V. (2001). *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II Sintaksa*. Prosvetno Delo.
- [13]. Pangaribuan, T., Haddina, E., & Manik, S. (2018). The Students' Error in Using Conjunction (Because, Since, as, in Case) in the Sentences. *English Language Teaching*, 11(4), 91. <https://doi.org/10.5539/elt.v11n4p91>
- [14]. Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Rilindja.
- [15]. Stevanović, M. (1989). *Savremeni srpskohrvatski jezik: Sintaksa*. Naučna knjiga.
- [16]. Sulejmani, B. (2015). Funksioni sintaksor i lidhëzës ndërsa në të folmet shqipe në Maqedoni. *Albanologjia*, 2(3–4), 25–27.